

ABETARJA



KUNDËR KORRUPSION

Photo source: Transparency International


Abetarja

**Kundër
Korrupsion**

Aa

Abuzimi me resurse publike

Kur personat që kanë një pozitë apo autoritet zyrtar krijojnë përparësi të padrejtë për veten apo personat tjerë nëpërmjet shfrytëzimit të resurseve publike (buxhetit, aseteve fizike apo komunikimeve zyrtare).



Aa

Auditimi

Auditimi është një ekzaminim i kualifikuar i llogarive, proceseve, funksionimit dhe performancës së një organizate buxhetore, me qëllim të ofrimit të një vlerësimi të pavarur dhe kredibil për përmbushjen e kërkesave ligjore.



Bb

Bankat 'guaskë' (Shell banks)

Bankat apo institucionet tjera fiktive, të themeluara në shtete tjera, por pa prezencë fizike dhe që përfshihen në aktivitete financiare pa u kontrolluar nga autoritetet. Qëllimi i këtyre institucioneve është fshehja e prejardhjes së pasurisë dhe shmangia nga taksat.



Bb

Barometri Global i Korrupsionit (Global Corruption Barometer - GCB)

Sondazhi më i madh botëror që realizohet nga Transparency International në nivel global për të matur opinionet e qytetarëve për korrupsionin. Ky sondazh realizohet që nga viti 2003.

Buxheti shtetëror

Tërësia e të hyrave, shpenzimeve, investimeve publike dhe fondeve rezervë brenda një viti kalendarik.

A **B** C Ç D DH E Ë F G GJ H I J K L LL M N NJ O P Q R RR S SH T TH U V X XH Y Z ZH

Cc

CPI (Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit)

Indeksi i publikuar në baza vjetore nga Transparency International, që rendit shtetet sipas niveleve të perceptimit të korrupsionit në sektorin publik, bazuar në vlerësimet e ekspertëve dhe matjet e opinionit publik.



Dd

Deklarimi i pasurisë

Obligimi ligjor i zyrtarëve publik për të deklaruar gjendjen e pasurisë dhe prejardhjen e saj. Pasuria dhe të ardhurat që duhet të deklarohen janë: pasuritë e luajtshme dhe paluajtshme; aksionet e zotëruara në shoqëri tregtare; letrat me vlerë dhe kriptovalutat; paratë e gatshme; obligimet financiare; donacionet e bëra për subjektet politike; si dhe të drejtat nga pronësia intelektuale. Pjesë e deklarimit duhet të jenë të dhënat mbi pasurinë e anëtarëve të familjes.



APPLICATIONS
FOR
**PUBLIC
CONTRACT**
ARE OPEN



Dd

Detyrimi

Përdorimi i forcës ose kanosjes për të detyruar personin tjetër të kryejë apo mos kryejë ndonjë veprim, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten apo tjetrin.

Dobia pasurore e kundërligjshme

Çfarëdo pasurie e cila fitohet drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga veprimet e kundërligjshme.

A B C Ç **D** DH E Ë F G GJ H I J K L LL M N NJ O P Q R RR S SH T TH U V X XH Y Z ZH

Dd

Donacionet politike

Çdo kontribut i dhënë për subjektet politike, duke përfshirë dhurata, subvencione apo forma të tjera - qofshin në para të gatshme apo kontribute në natyrë - pagesa të borxheve, shërbime dhe objekte në shfrytëzim. Donacione janë edhe shërbimet dhe vlerat materiale të cilat janë nën vlerën reale të tregut. Limiti maksimal i donacioneve nga personat fizik është 2,000 euro në vit, ndërsa 10,000 euro nga personat juridik.

“Dyert rrotulluese” (Revolving doors)

Lëvizja e individëve nga pozita publike në ato private, brenda sektorit të njëjtë. Kjo lëvizje mund të jetë subjekt për abuzime, nëse nuk rregullohet siç duhet dhe nëse nuk përfshihen kufizime kohore të nevojshme për kalimin nga pozita publike në atë private, apo anasjelltas.

Dhdh

Dhurata

Dhurata është një vlerë pasurore e pranuar nga zyrtarët publik në ndonjë rast të veçantë. Dhurata nuk mund të jetë mbi vlerën 50 euro dhe nuk mund të tejkalojë shumën prej 250 eurosh brenda vitit.

Personat zyrtarë nuk mund të pranojnë dhurata ose favore tjera për veten apo anëtarët e familjes, që kanë të bëjnë me ushtrimin e detyrave zyrtare dhe të cilat mund të ndikojnë në ushtrimin e detyrave zyrtare.



Ee

Etika


Parimet, vlerat dhe normat morale mbi bazën e së cilave mbështetet funksionimi dhe vendimmarrja e institucioneve publike, kompanive dhe shoqërisë.



Ee

Evazioni fiskal

Veprimet që kanë për qëllim zvogëlimin apo shmangien e obligimeve fiskale (tatimore) në buxhetin shtetëror, nga qytetarët dhe bizneset të cilat obligohen ligjërisht t'i paguajnë ato.



Ff

Falsifikimi i dokumenteve


Përpilimi, shënimi apo vërtetimi i të dhënave të rreme apo jo të duhura, me qëllim të shfrytëzimit të dokumentit të falsifikuar si origjinal.



Ff

Favorizimi

Trajtimi i pabarabartë dhe i padrejtë i personave, grupeve dhe bizneseve, me qëllim të shpërndarjes së resurseve, pozitive dhe privilegjeve tek personat e afërt, mbi baza jo-meritore dhe në dëm të tjerëve.



li

Integriteti

Sjellja e individëve në përputhje me standardet e moralit dhe etikës, duke qenë të pakompromis në kryerjen e veprimeve që janë të drejta dhe të ndershme.



li

Interesi publik

Interesi i përbashkët i qytetarëve, komunitetit dhe shtetit në përgjithësi në lidhje me çështjet e qeverisjes, ose ndonjë interes tjetër nga i cili preken të drejtat ose detyrimet e qytetarëve, duke përfshirë pronën publike, shëndetin, sigurinë, mirëqenien e përgjithshme dhe të tjera.



Jj

“Jakat e bardha”

Krimet jo të dhunshme që kryhen nga personat që ushtrojnë pozita të larta në segmente politike, ekzekutive, gjyqësore apo ekonomike. Këto krime karakterizohen nga mashtrimi ose fshehja, me qëllim të marrjes apo shmangies së humbjes së parave ose pronave, ose për të përfituar avantazhe personale apo biznesore.



Kk

Kapja e shtetit

Influencimi i vendimmarrjes shtetërore dhe politikave publike që ato në vazhdimësi t'ju shërbejnë interesave private.

Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar

Tejkalimi i kompetencave ose mospërmbyshja e detyrimeve ligjore nga zyrtarët me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete apo të tjerët, shkaktimit të dëmit ose shkeljes së të drejtat personave tjerë, shtetit, buxhetit dhe resurseve publike në përgjithësi.

Kk

Klientelizmi

Marrëdhënia ndërmjet individëve me status të pabarabartë ekonomik dhe social, që përfshin ofrimin e përkrahjes politike ose financiare në këmbim të ndonjë privilegji apo përfitimi të veçantë për maksimizimin e interesave private.

Konfiskimi i pasurisë

Marrja e përhershme nga shteti e pasurisë nga personat të cilët e kanë fituar atë nëpërmjet veprës penale, e urdhëruar me vendim të formës së prerë të gjykatës.

Kjo pasuri dhe të ardhurat nga shitja e saj bëhen pjesë e buxhetit të shtetit.

Kk

Konflikti i interesit

Situata dhe rrethana në cilën zyrtarët kanë ose mund të kenë interes privat që ndikon, mund të ndikojë, ose duket se ndikon, në kryerjen e paanshme, objektive dhe profesionale të detyrave të tyre.

Korrupsioni (i profilit te lartë dhe profilit të ulët)

Korrupsioni është abuzimi me pozitën dhe autoritetin publik, me qëllim të përfitimit privat ose për të tjerët. Korrupsioni mund të jetë i profilit të lartë dhe të ulët. *Korrupsioni i profilit të lartë* përfshinë kryerjen e veprave korruptive nga persona në hierarki të lartë të pushtetit dhe shkakton dëme serioze për shoqërinë. *Korrupsioni i profilit të ulët* përfshin rastet e izoluara dhe të përditshme të veprave korruptive dhe abuzimit me detyrat zyrtare gjatë ofrimit të shërbimeve bazike.

LL

Legjislacioni i porositur

Ligjet, aktet nënligjore apo vendimet tjera që bëhen përmes ushtrimit të ndikimit të paligjshëm, për t'i shërbyer interesave të caktuara të personave, grupeve ose bizneseve, dhe jo interesit të publikut.



LL

Lobimi

Çdo komunikim i ligjshëm që bëhet nga individë apo grupe të interesit me zyrtarët publik, për të ndikuar në ligjbërje, politikbërje apo vendimmarrje tjetër politike.



Lobistët

Personat që përmes ushtrimit të ndikimit në vendimmarrje politike synojnë t'i realizojnë interesat e tyre private.

LLL

Llogaridhënia

Parimi sipas së cilit individët dhe organizatat (publike ose private) duhet të japin përgjegjësi për aktivitetet dhe veprimet e tyre.



Mm

Mashtrimi

Paraqitja e rreme apo fshehja e qëllimshme e fakteve, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për veten apo personin tjetër.



Mm

Meritokracia

Sistemi sipas së cilit njerëzit përzgjidhen dhe vendosen në pozita bazuar në meritat e tyre, që përfshijnë kualifikimet, aftësitë, talentet, përkushtimin dhe të arriturat tjera.



Nn

Ndihma juridike falas

Shërbimi juridik falas i cili garantohet dhe financohet nga shteti apo organizatat tjera për të gjithë individët, pjesë e kategorive të cënueshme ose me të ardhura të pamjaftueshme, të cilët nuk kanë mundësi t`i drejtohen një juristi apo avokati për të zgjidhur problemet e tyre ligjore.



CORPORATION

Nn

Nepotizmi

Formë e favorizimit të personave, bazuar në marrëdhëniet e afërta, familjare apo shoqërore me ta, sipas së cilave dikush në pozita zyrtare përdorë autoritetin për t'i ofruar punë apo favor të afërmve edhe atëherë kur ata nuk janë të kualifikuar.

Ngrirja e pasurisë

Ndalimi i përkohshëm i përdorimit dhe transfereve të fondeve apo pasurisë së individëve nga ana e shtetit, mbi bazën e një vendimi gjyqësor.

Oo

'Off-shore'


Ofrimi i privilegjeve ligjore dhe fiskale nga vendet e ndryshme për kompanitë, trustet apo mbajtësit e llogarive bankare, edhe në rastet kur ato nuk kryejnë aktivitete ekonomike brenda atij juridiksioni. Në vendet e tilla ka ndërhyrje minimale nga autoritetet shtetërore dhe shkallë të ulët të detyrimeve fiskale.



Pp

Parajsa fiskale



Juridiksionet që përfshijnë qytete, shtete apo vende që ofrojnë trajtim favorizues fiskal, nga të cilat mund të përfitojnë qytetarët e huaj. Ato tërheqin bartjen e transaksioneve ekonomike në territoret e tyre duke mos aplikuar fare apo shkallë minimale të taksave.



Pp

Pastrimi i parave

Procesi i fshehjes së prejardhjes, pronarit apo destinimit të parave të fituara në mënyrë të kundërligjshme, duke i vënë ato në përdorim në aktivitete ekonomike të ligjshme.



Pp

Përvetësimi


Marrja ose shpërdorimi i dobisë pasurore, e cila i është besuar një zyrtari për shkak të detyrës apo të punës së tij.



Pp

Prokurimi publik

Prokurimi publik është blerja dhe menaxhimi i mallrave, shërbimeve dhe punëve nga shteti, me buxhet publik për nevoja të qytetarëve.



Qq

Qasja në dokumente publike

Parimi i ofrimit të qasjes për publikun në çdo dokument dhe informatë të prodhuar, pranuar, mbajtur apo kontrolluar nga institucionet publike.

Qeverisja e mirë

Një qeverisje që zhvillohet mbi parimet e pjesëmarrjes, llogaridhënies, transparencës, efikasitetit dhe gjithëpërfshirjes, duke respektuar sundimin e ligjit dhe minimizuar mundësitë për korrupsion.

Rr

Ryshfeti

Prokurimi publik është blerja dhe menaxhimi i mallrave, shërbimeve dhe punëve nga shteti, me buxhet publik për nevoja të qytetarëve.



Ss

Sektori publik dhe privat

Sektori publik përfshin të gjitha institucionet qeveritare dhe autoritetet tjera vartëse, të cilat shfrytëzojnë paranë publike për të ofruar shërbime, duke synuar përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Sektori privat përfshin të gjitha kompanitë, institucionet dhe entitetet tjera në pronësi private të cilat nuk kontrollohen apo menaxhohen nga sektori publik, por i nënshtrohen pagesave fiskale dhe detyrimeve tjera ligjore.



Ss

Sekuestrimi

Marrja e përkohshme nga shteti e pasurisë së personave të cilët dyshohet se e kanë fituar atë nëpërmjet veprës penale, e urdhëruar me vendim të gjykatës.

Sinjalizimi

Raportimi i punonjësve për ndonjë shkelje, neglizhim apo keqpërdorim të detyrës zyrtare, që përbën cenim të interesit publik brenda organizatës, institucionit publik apo kompanisë.

A B C Ç D DH E Ë F G GJ H I J K L LL M N NJ O P Q R RR **S** SH T TH U V X XH Y Z ZH

Ss

Sistemet e Integritetit (SI)

Aranzhimet politike, administrative dhe ligjore që inkurajojnë integritetin dhe krijojnë barriera ndaj korrupsionit.

Skemat piramidale



Ofertat apo planet për investime mashtruese, ku investitorëve ju premtohet fitim i madh, me pak investim. Skema funksionon sipas parave të kontribuara nga investitorët e mëvonshëm, të cilat përdoren për të paguar interesin e investitorëve të mëhershëm, pa ndonjë veprimtari operative, përveç grumbullimit të vazhdueshëm të fondeve të reja.

A B C Ç D DH E Ë F G GJ H I J K L LL M N NJ O P Q R RR **S** SH T TH U V X XH Y Z ZH

Ss

Sundimi i ligjit


Parimi që askush nuk është mbi ligjin, ashtu që sistemet, strukturat dhe praktikat ligjore zbatohen në mënyrë të barabartë dhe të drejtë, si për qeverinë ashtu edhe për qytetarët.



Shsh

Shpenzimet publike


Shpenzimet që i kryen shteti përmes institucioneve publike, administratës dhe organeve tjera, për plotësimin e nevojave kolektive dhe interesave të qytetarëve.



Tt

Transparenca

Parimi sipas së cilit aktivitetet, planifikimet, proceset dhe vendimmarrja e institucioneve publike dhe private, duhet të jenë të hapura dhe të qasshme për publikun.



Tt

Tenderi publik

Procesi dhe dokumenti i shpallur nga shteti si autoritet kontraktues, me qëllim të pranimit të ofertave nga operatorët ekonomik për ofrimin e produkteve dhe shërbimeve.



.....
declaration of income
Signed: _____

Uu

Ushtrimi i ndikimit

Ndikimi nga kushdo, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, në vendimmarrjen e personit zyrtar, me qëllim të përfitimit material për veten apo të tjerët.



Vv

Vlerësimi i rrezikut të korrupsionit

Procesi i identifikimit të rreziqeve dhe dobësive institucionale - zbrazëtirave ligjore, rreziqeve sistemike apo praktikave - që mund të paraqesin mundësi për shfaqjen e korrupsionit.

Vullneti politik

Përkushtimi i akterëve politik për të përkrahur adresimin e problemeve apo sfidave me të cilat përballet shoqëria, përmes zgjidhjeve të përshtatshme politike dhe ligjore.

Zz

Zbulimi i fshehtësisë zyrtare

Vënia e paautorizuar në dispozicion e informatave ose dokumenteve të shpallura me ligj si fshehtësi zyrtare, zbulimi i së cilave ka shkaktuar ose mund të shkaktojë pasoja të dëmshme.

Zyrtarët publik

Zyrtarët të cilët bartin autorizime publike dhe vepronë në kuadër të një institucioni publik.

A B C Ç D DH E Ë F G GJ H I J K L LL M N NJ O P Q R RR S SH T TH U V X XH Y **Z** ZH

Zhzh

Zhvatje

Shfrytëzimi direkt apo indirekt i pozitës apo autoritetit zyrtar të dikujt, me qëllim të arritjes së përfitimit përmes forcës apo kanosjes.



"This publication was produced with the financial support of the European Union. Its contents are the sole responsibility of the Kosova Democratic Institute (KDI) and do not necessarily reflect the views of the European Union."



RAPORTO KORRUPSIONIN

THIRR

**0800
77 777**

ose online në linkun
<https://raporto.kdi-kosova.org/>

**KORRUPSIONI
PAMUNDËSOHET
KUR RAPORTOHET**